L I G J
Nr. 8668, datë *23.11.2000*

PËR PAJISJEN E SHTETASVE SHQIPTARË ME PASAPORTË PËR JASHTË SHTETIT

(Ndryshuar me akt normativ nr. 5[1], datë 31.8.2001; me ligj nr. 8998, datë 31.1.2003)

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Pasaporta për jashtë shtetit është dokumenti që vërteton identitetin dhe shtetësinë shqiptare të mbajtësit të saj, me anën e së cilës ai mund të dalë e të hyjë nga dhe në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe të udhëtojë nga një shtet i huaj në një tjetër.

Pasaporta për jashtë shtetit është një dokument me shkallë të lartë sigurie, në përputhje me konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare.

Neni 2

Të gjithë shtetasit shqiptarë kanë të drejtë të pajisen me pasaportë.

Shtetasit shqiptarë, që me vendim të gjykatës kanë zotësi të pjesshme për të vepruar ose nuk kanë zotësi për të vepruar, pajisen me pasaportë vetëm me kërkesë të prindërve ose të kujdestarit të tyre.

Neni 3

Shtetasit deri në moshën 16 vjeç pajisen me pasaportë të vlefshme për 5 vjet, ndërsa ata mbi 16 vjeç pajisen me pasaportë të vlefshme për 10 vjet.

Në të gjitha rastet, vlefshmëria e pasaportës mund të zgjatet vetëm një herë, për një periudhë njëvjeçare.

Neni 4

Pasaporta shqiptare është e zakonshme, shërbimi dhe diplomatike.

Kriteret për lëshimin e pasaportës së shërbimit dhe asaj diplomatike përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 5

Pasaporta e zakonshme lëshohet nga Ministria e Rendit Publik, ndërsa pasaporta e shërbimit dhe ajo diplomatike lëshohen nga Ministria e Punëve të Jashtme.

---

[1] *Akt normativ nr. 5, datë 31.8.2001 është miratuar me ligjin nr. 8822, datë 15.10.2001.*

Për shtetasit shqiptarë, me banim jashtë shtetit, veprohet sipas rregullave të caktuara nga Ministria e Rendit Publik dhe Ministria e Punëve të Jashtme.

Neni 6

Shtetasi pajiset me pasaportë të zakonshme pranë organit të policisë, në juridiksionin e vendbanimit të vet të përhershëm, pasi paraqet:

- kërkesën me shkrim;
- çertifikatën e lindjes me fotografi;
- fotografi të përmasave 4 x 5 cm (copë tre).

Pajisja me pasaportë të zakonshme bëhet brenda një muaji nga data e paraqitjes së kërkesës.

Neni 7

Kërkesa dhe dokumentet për pajisjen me pasaportë, si dhe tërheqja e saj në organin e policisë bëhet nga vetë shtetasi ose nga i ngarkuari me prokurë të posaçme, ose nga prindi ose kujdestari për të miturit ose shtetasit pa zotësi për të vepruar.

Neni 8

Shtetasit i bllokohet pasaporta kur:

- ka të dhëna të mjaftueshme se mbajtësi i saj e ka marrë atë duke falsifikuar dokumentet për lëshimin e saj;
- në pasaportë ka shënime të bëra nga organe ose persona të paautorizuar;
- ka lënë funksionin, për të cilin ka marrë pasaportën e shërbimit ose atë diplomatike, me përjashtim të rasteve kur me ligj të veçantë është parashikuar ndryshe.

Neni 9

Pasaporta shpallet e pavlefshme kur:

- denoncohet nga vetë shtetasi se i ka humbur, i është vjedhur ose grabitur;
- është dëmtuar nga pakujdesia e mbajtësit të saj;
- i janë plotësuar fletët me shënime zyrtare;
- vërtetohen rastet e përcaktuara në nenin 8 të këtij ligji.

Neni 10

Vlerësimi dhe administrimi i pasaportës së pavlefshme bëhet përkatësisht nga organi që e ka lëshuar.

Neni 11

Shtetasi ripajiset me pasaportë në rastet e përcaktuara në nenin 9, si dhe kur pasaportës i ka mbaruar afati i vlefshmërisë. Për ripajisjen me pasaportë të zakonshme zbatohen të njëjtat rregulla si për marrjen e saj për herë të parë.

Neni 12

Tarifat për pajisjen dhe ripajisjen me pasaportë të zakonshme përcaktohen nga Këshilli i

Ministrave, me propozimin e Ministrit të Rendit Publik, Ministrit të Punëve të Jashtme dhe Ministrit të Financave.

Neni 13

Modeli i pasaportës dhe sistemi i lëshimit miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 14

Pajisja me pasaportë të re, sipas këtij ligji, do të bëhet pas përfundimit të vlefshmërisë së pasaportës ekzistuese me të cilën është pajisur çdo shtetas shqiptar.

Neni 14/1

Dispozitë kalimtare

(Shtuar me aktin normativ nr. 5, datë 31.8.2001; ndryshuar me ligj nr. 8998, datë 31.1.2003)

Neni 3 i këtij ligji zbatohet pas datës 31.12.2005. Deri në këtë datë, shtetasit e moshës mbi 16 vjeç pajisjen me pasaportë të modelit ekzistues të vlefshme për 5 vjet, me të drejtë përtëritjeje deri në 3 vjet, ndërsa të miturit e moshës deri 16 vjeç pajisen pranë organit të policisë me leje kalimi të modelit ekzistues të vlefshme për 6 muaj dhe vetëm për një udhëtim.

Neni 15

(Shtuar togfjalësh me aktin normativ nr. 5, datë 31.8.2001)

Dekreti nr. 7393, datë 12.6.1990 "Për lëshimin e pasaportave dhe dhënien e vizave", me ndryshimet e bëra, si dhe çdo dispozitë, që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen, duke mbetur në fuqi përkohësisht dispozitat e përcaktuara në nenin 14/1 të këtij ligji.

Neni 16

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 2817, datë 5.12.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani